

**PORTOFOL MIKS**

mundëson një balancë midis riskut dhe përfitimit

DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE

për fondet në monedhë të huaja

TREGJE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në tregjet e huaja të aksioneve/obligacioneve

Raport Mujor Korrik 2021

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 2,771,881
Cmimi i kuotës	102.8730
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nën depozitare	Raiffeisen Bank International, Austria

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne, të gjitha tarifat e tjera që i ngarkohen Fondit në perputhje me Prospektin si tarifa e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente nanciare që i përkasin tre kategorive kryesore të aseteve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të aseteve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të aseteve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë.

Nëse do të përdoren instrumente nanciare derivative, qëllimi do të jetë zbutja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përtimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përtimet tipike më të larta





Profili i parashikuar i rrezikut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të rrezikut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit




Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e aseteteve sic janë obligacionet dhe aksionet. Politika e investimit është ende në procesin e implementimit.

Portofoli i Titujve është i përbërë nga 29% e totalit të aseteteve në tituj borxhi të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe 26.4% nga tituj borxhi të korporatave dhe nga fonde investimi që investojnë në obligacione. Pjesa e aksioneve (39.5%) është e investuar kryesisht në tregje të zhvilluara: SHBA 34.1%; Zona Euro 50.2%; Britani e Madhe 5.7%.

Performanca e fondit

Fondi ka pasur një performancë të mirë gjatë Korrik. Vlera e kuotës së fondit ka pësuar rritje me **0.56%** në krahasim me muajin e kaluar, duke regjistruar performancën më të mirë mujore që nga lançimi.

Investimet e fondit në obligacione dhe në aksione sollen fitime gjatë muajit Korrik. Yield-et e obligacioneve u përballën me një trend rënës gjatë gjithë muajit, duke arritur përsëri nivele shumë të ulëta. Aksionet, nga ana tjetër, u përballën me pak volatilitet për shkak të shqetësimeve në lidhje me variantin Delta, por shpejt arritën nivele rekord të reja dhe e përfunduan muajin me vlera të larta.



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatsëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur. Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Korrik

Ndërsa duket e pashmangshme që varianti Delta do të çojë në një distancim vullnetar shoqëror ose vetë-izolim dhe ndoshta kufizime të caktuara gjatë dimrit, mendohet se nuk do ta pengojë rimëkëmbjen ekonomike të zonës së euros.

qëndrueshme dhe të qartë, para përfundimit të horizontit të parashikuar, kufirin prej 2%. BQE ka të ngjarë të rrisë programin e saj standard të blerjes së asetëve kur blerjet e emergjencës të përfundojnë, Marsin e ardhshëm dhe të lërë normën e saj të depozitave në -0.5% deri përtej vitit 2025.

Pavarësisht shqetësimeve në rritje për inflacionin që rëndon mbi shpenzimet reale, ndjesia në tregun e bonove duket të jetë pozitive. Yield-et afatgjata në tregjet e zhvilluara vazhduan rënien në Korrik, ashtu si dhe në Qershor, ndërsa çmimet u rritën. Kjo mund të vijë për shkak të përforcimit nga përfaqësuesit e bankave qendrore se rritjet më të fundit të inflacionit do të jenë kalimtare.

Çmimet e aksioneve u hasën me volatilitet gjatë këtij muaji. Rikthimi i Covid-19 i bëri investitorët të konsiderojnë mundësinë se kufizimet e reja do të ngadalësojnë rimëkëmbjen ekonomike dhe do të përmbysin rritjen e kapitalit. Megjithatë, rënia e çmimeve ishte vetëm e përkohshme dhe shumica e indekseve të rëndësishme në tregun e aksioneve vazhduan të performojnë mirë, duke arritur nivele të reja rekord në mes të Korrikut.

Rezerva Federale hodhi një hap të vogël drejt zvogëlimit përfundimtar të blerjes së asetëve, duke ndryshuar gjuhën në deklaratën e lëshuar gjatë Korrikut. Njoftimi pritet në Gusht ose Shtator, por ritmi më i ulët i blerjeve, me gjasa, nuk do të nisë deri në fillim të vitit 2022.

Në vazhdim, ETF (Exchange Traded Funds) kanë patur deri më tani 488.5 miliardë dollarë prurje të reja, ndërsa në vitin 2020 arritën në 497 miliardë dollarë gjatë gjithë vitit. Një zhvendosje, nga fondet e përbashkëta drejt ETF-eve, është vërejtur prej kohësh, pasi investitorët preferojnë kostot e ulëta, lehtësinë për t'u tregtuar dhe efikasitetin fiskal që ETF-et ofrojnë.

Banka Qendrore Europiane (BQE), nga ana tjetër, dëshiron të lërë normat në nivelet aktuale ose më të ulëta, derisa norma e inflacionit të ketë arritur në mënyrë të

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.